



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2026

V E N D I M

Nr.15, datë 28.05.2026

**PËR
“MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR
INSPEKTIMIN E VEPRIMTARISË SË SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE DHE
SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Znj.	Diana Dervishi	Anëtar

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 28.5.2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” miratuar me vendimin nr.11, datë 31.03.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP me propozim të Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Kontrollit, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimin e Rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 4 e nenit 181 dhe pika 3 e nenit 183 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

K Ë SHILL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti: Rregullore “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, sëbashku me Aneksin 1 “Për përcaktimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës administrative me gjobë”;
2. Qëndrimi i AKEP mbi komentet e ardhura për projektaktin;
3. Relacioni shoqërues i Projektvendimit;
4. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar,

nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N S E :

1. Ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji i ri nr. 54/2024 ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar, Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (EECC).
2. Me vendim nr. 28, datë 14.11.2025, Këshilli Drejtues i AKEP, ka miratuar dokumentin për këshillim publik “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”. Dokumenti u publikua për konsultim publik në faqen zyrtare të AKEP gjatë periudhës 17.11.2025-16.12.2025. Po kwshtu, me vendim nr. 4, datë 2.2.2026, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar për këshillim publik dokumentin “Për përcaktimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës administrative me gjobë”. Procesi i konsultimit publik u zhvillua për një periudhë 30-ditore dhe përfundoi me datë 5.3.2026.
3. Në përfundim të procesit të këshillimit publik të dy projektakteve të sipërcituara, pranë AKEP janë depozituar komente nga palë të interesuara:
 - me shkresën nr. 1746 prot., i AKEP, datë 10.12.2025, sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a., lidhur me projektaktin “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
 - në rrugë elektronike, në datë 27.02.2026, sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a., lidhur me dokumentin “Për përcaktimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës administrative me gjobë”.
 - me shkresën nr. 537 prot., AKEP, datë 06.03.2026, sipërmarrësi “One Albania” sh.a., lidhur me dokumentin “Për përcaktimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës administrative me gjobë”.
4. Në vijim të komenteve të ardhura, AKEP, ka përgatitur qëndrimin zyrtar mbi këto komente si dhe dokumentin përfundimtar të rregullores.
5. Projektakti përfundimtar “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” është në përputhje të plotë me detyrimet ligjore dhe institucionale të AKEP, të përcaktuara në nenin 181 e vijues të ligjit nr. 54/2024 dhe

ligjit nr. 99/2024, i cili ngarkon AKEP me përgjegjësinë për mbikëqyrjen, kontrollin dhe garantimin e zbatimit të kuadrit rregullator në fushën e komunikimeve elektronike.

6. Projektakti përmbush detyrimin e AKEP, për të miratuar akte nënligjore dhe metodologji të nevojshme për ushtrimin efektiv të funksionit inspektues, përfshirë përcaktimin e procedurave të inspektimit dhe metodologjisë për vendosjen e masave administrative me gjobë.
7. AKEP vlerëson se duke qenë se të dy aktet rregullojnë çështje të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, është vlerësuar e arsyeshme që ato të konsolidohen në një akt të vetëm, me qëllim rritjen e qartësisë normative dhe shmangien e fragmentimit rregullator.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, sëbashku me Aneksin 1 “Metodologjia për përllogaritjen e masës administrative me gjobë”, si pjesë përbërëse e saj si dhe dokumentin Qëndrimi i AKEP mbi komentet e palëve të interesuara, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim dhe Rregullorja “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
3. Ngarkohet administrata e AKEP për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Armer Juka	Bleron Dokle	Diana Dervishi